



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Prill 2023

Nr: 238

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË KAVAJË,  
PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË PUBLIKE TË NDALUAR, PËR ZGJEDHJET PËR  
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

**SUBJEKT:** Z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kavajë për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar.

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 18.3.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë kërkesën nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për ndalimin e veprimtarisë publike të raportuar për t’u zhvilluar më datën 22.03.2023, me temë “Takim me ekselentët e Qytetit dhe Njesive Administrative” nga bashkia Kavajë.

Data: 3 Prill 2023

Nr: 238

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës në bashkinë Kavajë.”

Në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 17.3.2023, Bashkia Kavajë ka raportuar veprimtarinë publike me objekt “Takim me ekselentët e qytetit dhe Njesive Administrative”, për t’u zhvilluar në datë 22.3.2023 ora 16:30. Në raportim është shënuar se folësit kryesorë dhe pjesëmarrësit do të jenë: Redjan Krali, Kryetar, Etjen Xhafaj, deputet i zonës, Shpend Barameta, Kryetar PS, Marinela Aliaj, Kryetar PS.

Me vendimin nr. 184, datë 20.3.2023, në përputhje me nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator është vendosur ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike me datë 22 Mars 2023.

Në vijim të procedurave administrative, nëpërmjet postës elektronike, po në datën 18.3.2023, është bërë njoftimi i bashkisë Kavajë mbi vendimin nr. 184, datë 20.3.2023, për ndalimin e zhvillimit të aktivitetit.

Pas këtij njoftimi, bashkia Kavajë më datë 21.3.2023, bën me dije se “...aktiviteti nuk organizohet nga ana e bashkisë, jemi thjesht pjesëmarrës, por e kemi deklaruar pasi do të hidhet në faqen e kryetarit për të mos pasur më probleme me denoncimet. Më poshtë ju sjell dhe dokumentin që tregon organizatorin...”.

Më datë 23.3.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, nga KRIIK ka marrë denoncimin për zhvillimin e veprimtarisë së ndaluar nga bashkia Kavajë.

Në këtë denocim pretendohet si vijon: “Nga informacioni i marrë nga vëzhguesit rezultoi se ky aktivitet ishte zhvilluar një ditë më përpara, pra në datën 21 Mars 2023. Sipas informacioneve të marra, aktiviteti ishte zhvilluar tërësisht sipas parashikimit të njoftuar në ndërfaqen e KQZ-së, përjashtoj ditën e zhvillimit, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=612184520726966&set=pcb.612185120726906>

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Data: 3 Prill 2023

Nr: 238  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës në bashkinë Kavajë.”

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se bashkia Kavajë nuk ka qenë në cilësinë e organizatorit të aktivitetit të sipër përmendur dhe ky aktivitet nuk përbën objekt raportimi në referim të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për raportim rëndon mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë. Në këtë rast vlerësohet se ka qenë një pakujdesi nga ana e bashkisë Kavajë në raportimin e aktivitetit.

Në këto kushte, duhet të pushohet procedimi administrativ dhe t'i tërhiqet vëmendja personit përgjegjës për raportim dhe duhet të tregohet kujdes i shtuar mbi vlerësimin e duhur të veprimtarive të cilat parashikohen nga legjislacioni në fuqi për t'u raportuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë.
2. Tërheqje vëmendje për raportimin e veprimtarive publike në mënyrë korrekte sipas parshikimeve ligjore.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 3 Prill 2023

Nr: 238  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës në bashkinë Kavajë.”